




GRANTI I PERFORMANCËS
GRANT UÇINKA
PERFORMANCE GRANT



VLERËSIMI I TREGUESVE TË GRANTIT TË PERFORMANCËS

KOMUNA E LEPOSAVIQIT



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria e Kosovës-Vlada Kosova-Government of Kosovo

MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHETIT LOKAL
MINISTRASIVO ADMINISTRACIJE LOKALNE SAMOUPRAVE
MINISTRY OF LOCAL GOVERNMENT ADMINISTRATION




Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

Kushtet Minimale

Komuna e Leposaviqit nuk është kualifikuar për grantin e performancës për vitin 2019. Kushti i parë minimal (opinionimi i auditimit së paku i pamodifikuar me theksim të çështjes) nuk është përmbushur. Opinionimi i auditimit të rregullsisë për vitin 2017 është opinionimi i kualifikuar me theksim të çështjes, i njëjtë ka qenë edhe në vitin 2016. Komuna ka shpenzuar **90.70%** të buxhetit për investime kapitale në vitin 2017, përderisa në vitin 2016 shkalla e shpenzimeve për këtë kategori ka qenë **78.00%**.



Performanca e Përgjithshme

Performanca e vitit 2016


Performanca e Komunës së Leposaviqit në 19 treguesit e vlerësuar është 19 pikë nga gjithësej 62 pikë të mundshme (**30.65%**).

Performanca mesatare e të gjitha komunave është **43.08%**.

Performanca e vitit 2017

Performanca e Komunës së Leposaviqit në 24 treguesit e vlerësuar është 33 pikë nga gjithësej 90 pikë të mundshme (**36.67%**).

Performanca mesatare e të gjitha komunave është **45.50%**.



Fusha I – Qeverisja Demokratike

Viti 2016

19 pikë nga gjithsej 32 pikë të mundshme në këtë fushë **(59.38%)**.

Kjo fushë përfshinë tri nënfusha:

- Roli i Kuvendit Komunal si organ mbikqyrës 80%
 - 4 tregues
- Pjesëmarrja dhe konsultimi i qytetarëve 40%
 - 3 tregues
- Gjithëpërfshirja 42.86%
 - 2 tregues

Performanca mesatare e të gjitha komunave në këtë fushë është **45.64%**.


Viti 2017

21 pikë nga gjithsej 37 pikë të mundshme në këtë fushë **(56.76%)**.

Kjo fushë përfshinë tri nënfusha:

- Roli i Kuvendit Komunal si organ mbikqyrës 60%
 - 5 tregues
- Pjesëmarrja dhe konsultimi i qytetarëve 40%
 - 3 tregues
- Gjithëpërfshirja 71.43%
 - 2 tregues

Performanca mesatare e të gjitha komunave në këtë fushë është **40.60%**.



Fusha II – Menaxhimi Komunal

Viti 2016

0 pikë nga gjithsej 17 pikë të mundshme në këtë fushë (0%).

Kjo fushë përfshinë tri nënfusha:

- Menaxhimi i burimeve njerëzore 0 %
 - 3 tregues
- Menaxhimi i financave dhe auditimi 0%
 - 1 tregues
- Ofrimi i shërbimeve 0%
 - 1 tregues

Performanca mesatare e të gjitha komunave në këtë fushë është **42.62%**.


Viti 2017

12 pikë nga gjithsej 40 pikë të mundshme në këtë fushë (30%).

Kjo fushë përfshinë tri nënfusha:

- Menaxhimi i burimeve njerëzore 30%
 - 4 tregues
- Menaxhimi i financave dhe auditimi 15%
 - 5 tregues
- Ofrimi i shërbimeve 60%
 - 3 tregues

Performanca mesatare e të gjitha komunave në këtë fushë është **44.50%**.



Fusha III – Transparenca dhe Integriteti

Viti 2016

0 pikë nga gjithsej 13 pikë të mundshme në këtë fushë (0%).

Kjo fushë përfshinë dy nënfusha:

- Çasja në informata 0%
 - 1 tregues
- Integriteti 0%
 - 2 tregues

Performanca mesatare e të gjitha komunave në këtë fushë është **46.76%**.


Viti 2017

0 pikë nga gjithsej 13 pikë të mundshme në këtë fushë (0%).

Kjo fushë përfshinë dy nënfusha:

- Çasja në informata 0%
 - 1 tregues
- Integriteti 0%
 - 2 tregues

Performanca mesatare e të gjitha komunave në këtë fushë është **63.10%**.



Qeverisja Demokratike (Treguesit e performancës: 1-10)

Komuna e Leposaviqit në fushën e Qeverisjes Demokratike ka treguar performancë të dobët në treguesit:

Treguesi 4 - Mbledhjet e Kuvendit Komunal me pjesëmarrje të kryetarit të komunës / 0 nga 3

Treguesi 5 - Diskutimi i gjetjeve dhe rekomandimeve (përfshirë edhe planin e veprimit) si të auditorit të brendshëm ashtu edhe të auditorit të jashtëm (ZKA) në mbledhjet e Kuvendit Komunal / 0 nga 5

Treguesi 7 - Aktet e miratuara në Kuvendin Komunal për të cilat është konsultuar publiku / 0 nga 6

Krahasuar me vitin 2016, performanca në fushën e qeverisjes demokratike ka qenë më të ulët për 2.62%.

Menaxhimi Komunal (Treguesit e performancës: 11 -22)

Komuna e Leposaviqit në fushën e Menaxhimit Komunal ka treguar performancë të dobët në treguesit:

Treguesi 11 - Zbatimi i skemës në shpërndarjen e vlerësimeve të punës për shërbyesit civil / 0 nga 3

Treguesi 12 - Procesimi i vendeve të hapura të punës përmes SIMBNj / 0 nga 2

Treguesi 13 - Prezantimi për diskutim në kuvendin komunal i raportit vjetor të zyrës së personelit të komunës për vitin paraprak / 0 nga 2

Treguesi 15 - Disiplina financiare në pagesa (pagesat e ekzekutuara brenda afatit ligjor / 0 nga 3 pikët

Treguesi 17 - Përditësimi i regjistrit të tatimit në pronë (ri-anketimi i objekteve sipas legjislacionit / 0 nga 3

Treguesi 18 - Niveli i vjeljes së tatimit në pronë (tatimet e paguara kundrejt shumës së faturuar) / 0 nga 5

Treguesi 19 - Adresimi i rekomandimeve me prioritet të lartë dhe të mesëm të auditorit të jashtëm (ZKA) / 0 nga 6

Treguesi 20 - Lëndët e shqyrtuara gjatë vitit / 0 nga 4

Krahasimi i performancës për vitet 2016 dhe 2017 nuk është i mundur për shkak të numrit të madh të treguesve të ngrirë në vitin 2016.

Transparenca dhe Integriteti (Treguesit e performancës: 23-27)

Komuna e Leposaviqit në fushën e Transparencës dhe Integritetit ka treguar performancë të dobët në treguesit:

Treguesi 24 - Realizimi i kërkesave të qytetarëve për çasje në dokumente publike / 0 nga 3

Treguesi 26 - Raportimi i planit vjetor të planit të integritetit në Kuvend Komunal / 0 nga 4

Treguesi 27 - Suspendimi i sherbyesve civilë ndaj të cilëve është ngritur aktakuzë / 0 nga 6

Krahasuar me vitin 2016, performanca në fushën e transparencës dhe integritetit është e njëjtë.